



Primitur / Dorezuar Prilbena / Predato Received / Delivery	02.11.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIC	6825/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1185/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në procedura sipas ankesës A.nr.1185/2023, të datës 20.09.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ nga Ferizaj, kundër Vendimit me numër protokollit ZQ/12.06.3439, të datës 12.09.2023, të Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1185/2023, e datës 20.09.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokollit ZQ/12.06.3439 i datës 12.09.2023, i Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ (*tutje vetëm ankuesi*), më datë 20.09.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimi me numër protokollit ZQ 12.06.3439 të datës 12.09.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 27.09.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesën me numër protokollit 6163/2023 e datës 20.09.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit ZQ/12.06.3439 të datës 12.09.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës; Aplikacionin e kërkesës për punë sekondare–aktivitet jashtë ATK-së; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 26.09.2023 nga Këshilli; Përgjigje në ankesë e datës 27.09.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes si : Akt Emërimit me Nr.267/2022 të datës 27.12.2022; Vendimin me Nr.267/2022 të datës 20.12.2022 për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Inspekto i lart tatimor; E-maili i datës 11.09.2023 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës; E-maili i datës 08.09.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës për ankuesin dhe E-maili i datës 07.09.2023 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se ankesa e ankuesit _____, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, dhe së i njëjti sipas Aktit të Emërimit me numër AE. Nr. 267/2022 të datës 27.12.2022, ushtron pozitën e punës “Inspektor i lartë tatimor” në Divizionin për Aktivitete Operative.

Me tej nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi më datë 11.09.2023, ka parashtruar kërkesë në Drejtorin e Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës (këtu e tutje ATK) për lejim dhe miratim të punës sekondare si “punëtor në repartin e prodhimit në subjektin “JORI”SHPK”.

Divizioni i Standardeve Profesionale me Vendimin me numër të protokollit Z.Q/12.09.2023, ka refuzuar kërkesën e ankuesit të datës 11.09.2023, me arsyetimin se kjo veprimtari bie ndesh me nenin 7 paragrafi 6 pika 6.2 të Rregullores Nr.ZQ/09-06-414 të datës 03.09.2021 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës, pasi që kjo lëmi nuk është e lejuar me këtë rregullore dhe si e tille cilësohet si pozitë e pajtueshme me pozitën e inspektorit tatimor. Pozita e inspektorit tatimor ka natyrë specifike të punës, dhe së ATK ka përcaktuar kufizime të veprimtarive jashtë ATK-së si masa për mbrojtje të integritetit.

Ankuesi brenda aftit ligjor parashtron ankesë në Këshill, duke kontestuar ligjshmërinë e Vendimit me numër protokollit ZQ 12.06.3439 të datës 12.09.2023 të Udhëheqësit të Divizionit të Standardeve në Administratën Tatimore të Kosovës. Pretendon se vendimet e brendshme të ATK-së janë favorizuese vetëm për zyrtaret e nivelit të lartë drejtues, ndërsa ankuesi si zyrtar i mesëm nuk ka të drejt të punoj në punë sekondare jashtë orarit dhe që nuk paraqet konflikt të interesit. Propozon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar, të anuloj vendimin e kontestuar dhe ankuesit ti aprovet kërkesa për punë sekondare.

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 ku përcaktohet se

“2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike” si dhe nenin 29 të këtij ligji që përcakton detyrimin për deklarimin dhe shmangien e konfliktit të interesit ku theksohet qartë se “1. Zyrtari publik ka detyrimin të shmangë çdo konflikt ndërmjet interesit të tij privat dhe interesit publik në ushtrimin e detyrës në pajtim me ligjin. 2. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë pa vonesë mbikëqyrësin e tij, në rast dyshimi për një konflikt interesi dhe të zbatojë urdhrat e institucionit për parandalimin e konfliktit të interesit. 3. Zyrtari publik ka detyrimin të informojë paraprakisht mbikëqyrësin e tij dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore për çdo veprimtari me pagesë, që kryen jashtë detyrës së tij vetëm në pajtim me ligjin”.

Për vendosje të drejt dhe meritore, Kolegji analizoj edhe Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publik, me theks të veçantë mori parasysh dispozitat e nenin 11 ku përcaktohet qartë se: 1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse: “1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private; 1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë; 1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë”, si dhe nenin 20 paragrafi 3 me të cilin është paraparë: “3. Institucionet në kuadër të akteve të tyre të brendshme, parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucionit përkatës.

Për me tepër Kolegji iu referua edhe dispozitave të Rregullores së Brendshme Nr.ZQ/09-06-414 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës përkatësisht nenit 5 paragrafi 4 ku është përcaktuar se: Zyrtari i ATK-së nuk mund të angazhohet në punë sekondare pa u pajisur me autorizim nga ATK-ja për punë sekondare...” Nenit 6 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. “Zyrtari i ATK-së mund të angazhohet në punë sekondare në lëmit si: shkencë, sport, mësimdhënie, trajnime, seminare, hulumtime borde (Ndërmarrje Publike, Ndërmarrje Shoqërore dhe Organizata Buxhetore) kulturë dhe veprimtari humanitare. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari i ATK, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozitat tjera ligjore. 2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në situata specifike Zyra e Standardeve Profesionale (tani e tutje ZSP) mund të lejon angazhimin e zyrtarit të ATK-së në aktivitetet tjera që nuk janë të ndaluara me këtë rregullore apo me legjislacionin në fuqi” Nenit 7 paragrafi 6 nën paragrafin 6.2 dhe 6.3 ku përcaktohet qartë se: 6.Zyra e Standardeve Profesionale refuzon kërkesën për angazhim në punë sekondare, në rastet kur: “6.2. Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konfliktin e interesit; 6.3. Angazhimi në punë sekondare pengon aktivitetin në ATK”.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në kuadrin ligjor si me lartë si dhe mbështetura në provat materiale të kësaj çështje konstatoi se Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër protokolli ZQ 12.06.3439 të datës 12.09.2023 me të cilin e ka refuzuar kërkesën për lejimin e punës sekondare të ankuesit ka vepruar në pajtim me dispozita materiale si me lart, sepse marrëdhënia e punës në shërbimin civil është marrëdhënie primare dhe se nëpunësi civil mund të angazhohet në veprimtari/pune sekondare/punë jashtë




shërbimit civil vetëm në rast se ky angazhim nuk sjell rrethana të konfliktit të interesit në raport me ushtrimin e punës në shërbimin civil dhe nuk pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare apo realizimin e objektivave të institucionit. Rrjedhimisht, përveç që angazhimi në biznes privat (*punëtor në repartin e prodhimit tek Biznesi "JORI SHPK"*), nuk lejohet si veprimtari sipas nenit 6 të Rregullores ZQ/09-06-414 së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës, njëkohësisht duke qenë së ankuesi ushtron pozitën e inspektorit tatimor në ATK, ku si detyra të punës ka: vizita të tatimpaguesit, ekzaminon libra, llogaritë dhe regjistrimet e mbajtura të tatimpaguesve në lidhje me zbatimin e legjislacionit tatimor në mënyrë të saktë, të plotë dhe në kohë në lidhje me obligimet e tyre tatimore, në vlerësimin e Kolegjit ushtrimi i punës sekondare të ankuesit tek biznesi privat JORI SHPK, si tatimpagues dhe në pronësi të bashkëshortes mund të ve në pikëpyetje besueshmërinë në veprimet te paanshme të ankuesit dhe të sjell konflikt të mundshëm të interesit, e mbi këtë bazë, mund të cenojnë besimin e publikut në integritetin dhe mandatin e Administratës Tatimore të Kosovës. Nisur nga këto rrethana dhe konstatime rrjedhe së pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara.

Theksuar si me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur MbiKëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1185/2023

Flakron GASHI


Procesmbajtës

Ardita HAXHNIKAJ-DEMI



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.